



PROCESVERBAL III/2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (trtë) për vitin 2025 të Komitetit për
Komunitete Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 25.03.2025
Ora : 09:00

Prezentë:

Z. Denis Sofra - Kryesues

z.Nazim Shabanaj
znj.Aferdita Morina
z.Zek Berisha
znj.Melisa Shabanaj
z.Aziz Bytyqi
znj.Dorentina Zenelaj

Të pranishëm tjerë:

Xheladin Sadikaj-Zyrtar për Kthim dhe Komunitete
Habibe Bytyqi - Zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi z. Denis Sofra cili propozoi këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;**
- 5. Të ndryshme;**

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Denis Sofra-e hedh në votim pikën 1

Unanimisht miratohet

Pika 2.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Denis Sofra:laboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-Përshendet të pranishmit,po besoj që jeni ne dijeni që me 31.01.2025 e kemi marrë këtu një vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të dy parcelave në Agro Zonën industriale në Samadrexhë,kemi marrë miratimin nga MPL për me e formu Komisionin për me i zhvillu procedurat për dhënien në shfrytëzim të atyre parcelave .Komisioni përbëhet prej 5 anëtarëve 2 nga Kuvendi,2 nga Ekzekutivi dhe 1 nga Shoqëria Civile.

Denis Sofra- e hedhë në votim pikën 2

Unanimisht miratohet

Pika 3.Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;

Denis Sofra-laboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-Dhe këtu bëhet fjalë për një parcelë në Zonën Industriale në Shirokë,aty ka qenë nga 2017-2022 një kontratë për qështjen e grumbullimit të mbeturinave për rrënimin objekteve të Komunës sonë.Kemi marrë miratimin për me i zhvillu procedurat.

Denis Sofra-e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 4.Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme;

Denis Sofra-laboron pikën dhe hap debatin

Avni Bytyqi-Këtu bëhet fjalë për një parcelë dikun 250m2 te Handikosi,është pronë e Komunës dhe Komuna ka shprehë interesimin që ta jepë në shfrytëzim për ndërtimin e objekteve afariste banesore sipas

planit të paraparë në harta zonale të Komunës Suharekës. Ky është veq një hap paraprak për me leju me shfrytëzu një procedurë të konkurimit të hapur .

Denis Sofra- e hedhë në votim

Unanimisht miratohet

Pika 5. Të ndryshme;

Denis Sofra- e hap debatin

Nazim Shabanj- kërkon që të rregullohet këndi i lojrave në Fshatin Gelancë.

Takimi përfundoi :

9:15